



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 1, datë 10.02.2026

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 10.02.2026

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi : Përshëndetje!

Të nderuar këshilltarë! I nderuar zëvendëskryetar, përfaqësues të administratës, media!

Të nderuar të pranishëm!

Sot hapim sesionin e ri të punimeve për vitin 2026. Një vit me përgjegjësi të reja dhe pritshmëri më të mëdha për qytetarët e Durrësit. Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për Këshillin Bashkiak Durrës. Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe do të informohemi mbi raportin 12 mujor të punës së Këshillit për vitin 2025. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretariati i Këshillit. Ftoj sekretaren të procedojë me thirrjen e emrave të këshilltarëve

Dorina Milja: Fillojmë me prezencën.

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri....

36 Këshilltarë në sallë.

V.O (Hyn me vonesë në sallë këshilltarët: Denis Lika, Ervish Bekteshi Gjithsej me fillimin e mbledhjes 38 këshilltarë).

Gjatë shqyrtimit të pikës parë të rendit të ditës largohen këshilltarët e opozitës. Në sallë mbetën 25 këshilltarë. Për shkak të rënies së kuorumit Drejtuesi i seancës vendosi që mbledhja të shtyhet për 5 minuta pasi 2 këshilltarë nuk arrinin të futeshin në mbledhje pasi qytetarët e pranishëm poshtë bashkisë nuk lejonin kalimin e tyre. Mbledhja rifilloi me 27 këshilltarë të pranishëm në mbledhje.)

Denisa Luarasi: Meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen.

Po kalojmë me leximin e pikave të rendit ditës.

Dorina Milja : 37 se erdhi Denisi.

Edlira Shemsi : Dua fjalën.

Denisa Luarasi: Të lutem të lexojmë rendin e ditës, të lutem...

Edlira Shemsi : Jo kemi të drejtë të flasim pa filluar rendin e ditës. Na keni çuar një pikë në rendin e ditës 24 orë para pa asnjë konsultim për kryetarët e grupeve të këshillit për të dhënë një bonus, por.....

Denisa Luarasi: E ka vendosur kryesia....Të lutem ...

Edlira Shemsi : Ata protestojnë jashtë. Jo s'mund ta pranojmë, ky këshill sot nuk mund të bëhet kështu. Është i jashtëligjshëm.

Denisa Luarasi: E ka vendosur kryesia.

Edlira Shemsi : Asnjë nga ne nuk ka të drejtë të shpronsojë ata sot që janë atje në hipotek me të drejtat, tani që flasim janë në hipotekë me të drejtën e të qenit pronar. Asnjë nga ne nuk mund të dalim mbi gjykatat. Sot janë në gjykatë përballë ligjeve të shtetit me bashkinë dhe me të gjitha institucionet e tjera, që kërkojnë t'i marrin pronën me dhunë. Ky këshill nuk bënë sot....

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit po e fillojmë me leximin e rendit ditës.

Të lutem mos bëj zhurmë. Të lutem... ..

Edlira Shemsi: ...24 orë para një pikë kaq të rëndësishme për ata qytetarë të Durrësit, që kërkojnë t'i marrin pronën me dhunë. Absolutisht, ku i gjetët paret juve me i dhënë atyre bonusin e qirasë.

Denisa Luarasi: E ka vendosur kryesia të futet në rend të ditës.

Edlira Shemsi: Ku i gjetët paratë ju për 24 orë.

Denisa Luarasi: E dashur ...

Edlira Shemsi: Ky këshill është i paligjshëm sot. Asnjë mbi ne s'del mbi ligjin.

Denisa Luarasi: Do kalojë në votim edhe...

Edlira Shemsi: Asnjë s'del mbi ligjin, se ata janë akoma në hipotek për pronën e vet. Janë në të drejtën e vet . Janë pronarë të atyre pronave. Kush jemi ne që i heqim pronën atyre.

Rolant Xhelilaj : Ti je keq me informacion...

Dritan Burgija: Kryetare mund ta marrë fjalën.

Denisa Luarasi: Po.

Joniada Musaraj: Procedura parashikon leximin e rendit të ditës. Nuk mundemi ne të mos bëjmë respektimin e rregullores.

Denisa Luarasi: Të lutem, faleminderit...

Dritan Burgija: Dakord, dakord për procedurë kemi. Një email që na ka ardh...

Denisa Luarasi: Mund të vazhdojmë...

Dritan Bugija: Jo një sekond ta them, do vazhdojmë kështu që edhe të merrmi vesh.

Denisa Luarasi: Patjetër.

Dritan Bugija: Tani, kemi një email, një email zyrtar ku një përfaqësuese e atyre poshtë ka bërë një email dhe

Denisa Luarasi: Po s'ka bërë 24 orë ka ardhur mbasdite, s'kam qenë.. Po.

Edlira Shemsi: Të hiqet automatikisht.

Ardian Muka: Ato e dinë 24 orëshin. Një përfaqësi....

Denisa Luarasi: Ju lutem duhet njoftim me shkrim.

Ardian Muka : E ka sjellë me email, me shkrim e ka me shkrim...

Denisa Luarasi: Okej (*okay*) mos e votojmë rendin e ditës.
E hedhim në votë për bonusin pikën e 13, kur ta hedhim votim...
Ok, vazhdojmë me rendin e ditës.

Ardian Muka: Jo nuk do vazhdojmë, ndryshe do të prishimin mbledhjen.

Denisa Luarasi: Pika 1 e rendit të ditës...

Edlira Shemsi: Nuk mund të vazhdojmë. Thyerje e hapur e ligjit.

Ardian Muka : Nuk mund të vazhdojmë, se përfaqësuesit që dëgjojmë në protestë, janë në të drejtën e tyre, 24 orë para siç e keni futur këtë materialin 24 orë , edhe ato ju kanë çuar një email 24 orë. Një përfaqësues i tyre, jepni urdhër kush don nga ato të futet në mbledhje. Kaq po kërkojmë ne.

Flutura Kasa: Inxhinier a mund të flas dhe unë?

Ardian Muka : Patjetër.

Flutura Kasa: Tashi Denisa, unë sot jam me ato atje. S'mund të më bini ju mua, pavarësisht se kam votuar okej, sepse e lexova për qiranë, po të jetë hera e fundit që ne na vjen në kryesi se unë e deklaroj që sot votën kundër. 24 orë para punonjësit e bashkisë të punojnë 24 orë. Se ditën atje poshtë me thënë që ju shtrydhin si limon dhe ju hedhin. Mua nuk më shtrydh dot njeri si limon. Ta keni të qartë. Unë kam votuar mbrëmë okej, sepse është qira për ato njerëzit atje përjashtë. Por unë më nuk votoj pro 24 orë para mbledhjes.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Flutura Kasa: Se ju kështu, ju kështu i hapni të drejtën atyre. Shih si thotë ai 24 orë thotë pranoje dhe atë. Atëhere o do ecim në standarte të njëjta ose ndryshe do dalim kundër.

Dritan Burgija: A mund ta vazhdoj, a mund ta vazhdoj, a mund ta vazhdoj dhe një çikë?
A mund ta vazhdoj?

Denisa Luarasi: Ta kishim lexuar pak rendin e ditës. Të lutem.

Dritan Burgija: Dëgjo se mbi bazën e kësaj ne do mbajmë qëndrim. Domethënë do rrimë në sallë apo s'do rrim në sallë. Ka mundësi të merremi vesh, të dëgjojmë njëri-tjetrin.

Tani ato banorët atje pavarësisht asaj votës okej, se duke qenë bonus qeraje dhe menduam që është diçka që i shërben qytetarëve me një pamje të parë 24 orë përpara, duke mos pasur kohën e duhur po kemi dhënë okej, aty domethënë që të futet në rend dite. Por, konsiderohet sot gabim, sepse ata banorë nuk kërkojnë as bonus qeraje, nuk kërkojnë as shtëpia sociale, një sekond ma le ta mbaroj, ta mbaroj. Nuk kërkojnë as....Ato kanë kërkuar.....

Denisa Luarasi: Do të thoja që ta votojmë.... hiqeni nga rendi i ditës edhe...

Dritan Burgija: Po dakord, ato kanë kërkuar që kjo domethënë, ato kanë kërkuar të anulohet projekti TID fare. Janë duke negociuar me ADF-në bëjnë protesta aty poshtë dhe kjo është. Nëse ju me prepotencë sot do vazhdoni me këtë, do vazhdoni me këtë në rend dite, ne do na detyroni pastaj që t'i bëni vetë punët dhe ne s'do marrim pjesë as në pikat e tjera. Do na bëni të lëmë sallën Ne nuk duam ta bëjmë këtë. Kështu që hajde të marrim një vendim të gjithë bashkë.

Ardian Muka : Po kërkohet një përfaqësues i tyre të jetë prezent në mbledhje. Mbledhjet janë të hapura, kjo dihet. E kanë bërë kërkesën me shkrim.

Edlira Shemsi : Ore s' duan qera ato.....

Rolant Xhelilaj: O doktoresha..

Denisa Luarasi: Të lutem fjalën e ka z.Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: O doktoresha, o doktoresha, dil atje poshtë po të duash.

Edlira Shemsi: Ata s'po kërkojnë qera Landibonus qiraje...

Rolant Xhelilaj: Doktoresha dil atje poshtë, po të duash.
Fole të dëgjuam. Dëgjo pra dëgjo njëherë deri në fund.

Edlira Shemsi: Ata janë pronar të ligjshëm me hipotekë. Me çfarë drejte morale i thua dil përjashtë.

Rolant Xhelilaj: O ti motra ... po ti se ke konceptin.
O doktoresha ja përgjigja, po prit dëgjoje përgjigjen. Dëgjoje.
Ti je komplet e painformuar dhe po luan rolin e një personi

Edlira Shemsi: Aq e informuar sa s'ka.

Rolant Xhelilaj: Më dëgjo deri në fund. Më dëgjo deri në fund, motra. Më dëgjo.
Unë e kam jo vetëm me ty, por dhe me zotin Burgija.

E kaluam thotë si kryesi, sepse ne nuk e menduam. Bonusi qeras nuk ka lidhje fare as me kërkesën e tyre për anulim, as me ndjekjen e procesit gjyqësor, as me një gjë. Është një ide, një lloj ndihme që bashkia i jep dhe çdokush nga ato e merr në qoftë se don dhe duhet të aplikoj.

Edlira Shemsi: Është një ofertë e pakërkuar.....

Rolant Xhelilaj: Të lutem më dëgjo, më dëgjo, motra më dëgjo.

Edlira Shemsi: Bonusin nuk të kanë kërkuar, kujt po ja jep ti? Kush ta ka kërkuar?

Rolant Xhelilaj: O motër, dua unë ta jap moj.

Edlira Shemsi: Ti s'ja ke dhënë atyre që e kanë 2 vjet e gjys që s'marrin bonus tërmeti.

Llesh Çuni : Po lëre të mbaroj, të flasë.

Rolant Xhelilaj: O Zot i madh, o Zot i madh.

Kur vjen njeri atje te zyra jote kështu i le të flasin ë?

Edlira Shemsi : Jo, patjetër....

Rolant Xhelilaj: Nuk i lënë atje. Atje është prona jote. Kurse këtu është edhe këtu prona jote.

Edlira Shemsi : Atje i shërbejë atyre që duhet t'iu shërbejë....

Rolant Xhelilaj: Mos lër nam, mos lër nam.

Edlira Shemsi: Janë akoma pronarë të ligjshëm me hipotekë.

Rolant Xhelilaj: Ata e kanë kuptuar sakrificën tënde dhe të shokëve tuaj.

Edlira Shemsi: S'kam shokë, jepu përgjigje qytetarëve.

Rolant Xhelilaj. Më dëgjo deri në fund këtu, sepse me ato jemi të gjithë ne, për një kërkesë normale të tyre për vlerësimin. Për të gjithë të tjerat jemi të gjithë bashkë këtu edhe me ato komshinë që ke aty ngjitur që ky projekt është projekt i rëndësishëm për qytetin. Është projekt i vonshëm që duhet të ishte bërë me kohë. Të gjitha këto kërkesa, që ato bëjnë janë në të drejtën e tyre. Kujdo që i preket interesi reagon në një farë mase. Ne këtu jemi përfaqësues të njerëzve, të komunitetit, na dhemb 20 veta, 30, 70 apo 100, por në fund të fundit jemi përfaqësues të gjithë qytetit të Durrësit, dhe e dimë që ky projekt të paktën një pjesë e mirë e juaja që ka qenë këtu dhe e ka miratuar, e ka firmosur, e ka vulosur me vote dhe me të gjitha, sot është një lloj... nuk e di, qëndrim i çuditshëm. Jo normal.

Edlira Shemsi : Jo normal, por është i

Rolant Xhelilaj: Komenti që bëri zoti, komenti që bëri...

O ti shoqe ti s'e ke idenë për çfarë flitet moj.

Ti ti je rehat. Ti s' ke idenë për çfarë flitet.

Edlira Shemsi : Jo mor zotni se e kam lexuar shumë mirë projektin unë.

Është një projekt rivitalizues, jo projekt shkatërrimtar. Nuk ka asnjë vend të tillë që shkruhet që atyre njerëzve do tu prishen shtëpiat, do restaurohen... nuk mund të prishen shpia që si shembi as tërmeti.

Rolant Xhelilaj: Je rehat, ti je rehat doktoresha dhe s'kemi ku të çojmë se njerëzit me këtë lloj rehati duhet të vizitohen, po te ty. Po ti je rehat motra.

Edlira Shemsi : Nuk është ashtu fare nga një projekt restaurus në një projekt shkatërrues.

Rolant Xhelilaj: Unë jam dakord.....

Po diskutove për projektin ...

Edlira Shemsi: Aq i di, se i kam lexuar të gjitha.

Rolant Xhelilaj: Ore ti ke drejtë...

Edlira Shemsi: Si u tjetërsu projekti TID?

Rolant Xhelilaj: Megjithëse, megjithëse ka fuqi ajo, se ka ngrënë vezë që në mëngjes.

O zoti Burgija ndihmoje çik atë shoqen, ndihmoje pak.

Dritan Burgija: A ka mundësi ta marr pak fjalën?

Rolant Xhelilaj: Jo prit ta mbarojmë fjalën.

Edlira Shemsi: Përgjigja është shumë e thjeshtë, është shkruar projekti nga një projekt restaurues në një projekt shkatërrimtar. Në asnjë vend në asnjë fazë të projektit, nuk është shkruar se do shkatërrohet, do të prishet shtëpia. Kjo është bërë në fund fare. Ma jepni, ma jepni....

Rolant Xhelilaj: Ore me gjithëmend e thua këtë ti? Po ti je rehat, ti je rehat. O motra, ti je rehat. Ty të ka thënë ndonjëri ndonjë llaf te veshi dhe vjen këtu bën si garipe, bën si luftëtare e vijës së parë, që po mbron ato njerëzit aty.

Edlira Shemsi : Jo zotëri

Rolant Xhelilaj: Ato njerëzit aty më shumë janë miqtë tanë dhe vihemi ne në vështirësi, jo ti që ti s'e ke idenë se ç'ndodh te ajo zonë aty. Ti je duke folur kodra mbas bregut.

Edlira Shemsi :në bazë të projektit.....

Rolant Xhelilaj: Nuk jemi duke folur për projektin, o ti zonjë...
Ore hiqa atë....

Flutura Kasa : Lëre se e ka mësuar përmenç ajo...

..... shumë zhurmë në sallë, flasin njëkohësisht....

Rolant Xhelilaj: O zoti Muka....

Denisa Luarasi: S'ka përfunduar akoma fjalën zoti Xhelilaj.
Të respektojmë zotin Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Zoti Ardian Muka të paktën ti mos ndërhy, mos bjer në batakun e doktoreshës.
Mos ndërhy. Zoti Muka, mos ndërhy.

Ardian Muka : Për korrektesë asnjëherë se kemi votuar pozitivisht këtë projekt

Denisa Luarasi: Zoti Xhelilaj e mbarove fjalën?

Ardian Muka : kemi thënë që është një projekt pozitiv për qytetin,...

Rolant Xhelilaj: Po pra, ta dëgjoj ajo.

Ardian Muka:por pa shkelur në të drejtat e atyre qytetarëve.....

Rolant Xhelilaj: Po patjetër...

Ardian Muka: qytetarët e kanë çuar këtë proces në gjykatë. Është një proces në gjykim dhe nuk mund të çoni letra që nesër të dalin nga shtëpia. Kot i çoni letrat.

Rolant Xhelilaj: Ardian Muka të bëj pyetje ty? Nuk ka rëndësi nuk na hyn ne në punë.
Të bëj një pyetje?

Edlira Shemsi : Nuk na intereson neve, i intereson atyre atje përjashtë.

Dritan Burgija : Kam kërkuar fjalën me mikrofon.

Rolant Xhelilaj: Po ta mbaroj unë apo jo?

Dritan Burgija : Po, ta mbarosh.

Rolant Xhelilaj: Po s'po më lë, s'po më lë komshia jote.
E ke komshinë të pabindur.

Edlira Shemsi : S'na lën ato qytetarët atje poshtë.

Rolant Xhelilaj: Mos, mos, e di sa e ke hallin e atyre qytetarëve.
Je e dalluar për atë pjesë ti. Je e dalluar.

Edlira Shemsi :Aq e dalluar sa s'ka.....

Rolant Xhelilaj: Mua më vjen keq, mua më vjen keq për, më vjen keq për Ardian Mukën që unë e di që është pjesë edhe e miratimit dhe projektit, është dhe përfitues e të gjitha me radhë, por më vjen keq për një gjë..

Ardian Muka : Jo, jo, projekti nuk ka kaluar në Këshill Bashkiak....

Rolant Xhelilaj: ... Po mirë po të them opinionin tim Ardi, jo mbrapa mbas meje kundërshtojë Ardi, Ardi mbas meje kundërshtojë.

Unë më vjen çudi që ju diskutoni bonusin si ndërhyrje te projekti dhe te vendimet e marra nga këshilli i parë, para ardhjes tonë në këtë këshill, si ndërhyrje që atyre ju imponohet projekti e ku di unë me radhë. Bonusi është një vendim i Këshillit Bashkiak në ndihmë të tyre.

Kush nuk e do, nuk e merr. Dhe unë s'e kuptoj në qoftë se ke interes ti me të gjithë Burginë me prish mbledhjen është tjetër gjë. Kaq.

Ardian Muka : Një përfaqësues nga ato njerëz atje se nuk mund të mbyllim sytë përpara këtij problemi, le të jetë prezent në mbledhje, që kur të diskutojmë....

Rolant Xhelilaj: Prit pa edhe për përfaqësuesin.

Ardian Muka:ta dëgjojmë dhe atë. Kaq po këkojmë, prezencë.

Rolant Xhelilaj: Jemi dakort me përfaqësuesin vetëm një gjë...

..... shumë zhurmë në sallë...flasin gjithë përnjëherë....

Ardian Muka : Të futet përfaqësuesi dhe le të vazhdojmë...

Flutura Kasa: Tek pika e 13 thirre përfaqësuesin. Kur të shkojmë tek pika 13.

Ta mbarojmë rendin e ditës njëherë.

Rolant Xhelilaj: Dëgjo, e di si është puna?! Fajin e ke kryetare që duhet lexuar njëherë rendi ditës. Edhe s'ka filluar mbledhja dhe vazhdon bëhet një teori.

Se dhe përfaqësuesin Ardian Muka e din mirë edhe të paktën unë e di mirë nga periudha, që kemi qenë këtu në Këshill Bashkiak, që nuk guxonim ta kërkonim jo të futej përfaqësuesi, por toleranca jonë toleranca jonë është aq e madhe sa s'bën vaki. Por këtu, unë ju tërheq vërejtjen për një gjë. Në qoftë se ka pas kërkesë jeni të detyruar t'i ktheni përgjigje dhe përfaqësuesi nuk është një përfaqësues, por është përfaqësuesi me emër që bie, që i jepet kryesisë, që miratohet nga kryesia, edhe në orët e vona siç miratuam atë pikë, miratohet dhe përfaqësuesi dhe të vijmë dy mos vijë një, që mos të jetë ai në kushte të vështira se është një, le të jenë dhe dy, por të miratohet nga ne si kryesi me emër me mbiemër. Kush është përfaqësuesi? Po pra edhe të kalojë nga kryetarja te ne. Tashti kjo është një lloj presioni që ju.....

Jo unë s'e kuptoj pse e bëni. Unë s'e kuptoj pse e bëni.

Ardian Muka : Janë në të drejtën e tyre

Rolant Xhelilaj: Kush ja hoqi më të drejtën? Kush e hoqi?

Ardian Muka : Mbledhjet janë të hapura. Nuk keni nevojë të merrni policinë bashkiake për të fut një përfaqësues...

Rolant Xhelilaj: Jo, jo policinë bashkiake.....

Flutura Kasa: Policinë bashkiake do e vesh se shau me libër shtëpie, gjujti me vezë.

Si mos ta vë policinë bashkiake?! Se ju hytë si zotërinj, komod, s'ju ngacmoj kush.

Denisa Luarasi: Tani të fillojmë me rendin e ditës....

Mund të filloj pak me rendin e ditës...

Të lutem të filloj pak me rendin e ditës dhe pastaj e votoni.

Dritan Burgija: Thashë në varësi të kësaj është qëndrimi jonë.

Çfarë problemi ka, çfarë problemi ka nëse vjen një njeri intelektual aty që është i prekur direkt?

.....*Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...*

Denisa Luarasi: Mund të lexoj pak rendin e ditës.

Është marrë vendimi. Fillojmë.....

Dritan Burgija: Është marrë vendimi, vazhdoni mbledhjen vetë.

Merrni vendim që të fusni atë, në qoftë se nuk na doni ne jashtë.

Joniada Musaraj: Po kemi votuar pro në kryesi.

Dritan Burgija : Po kam votuar pro, sepse ishte bonus i qerasë dhe mendova duke qenë.. Shiko ta marr fjalën me mikrofon. A ta marr fjalën me mikrofon? Ka mundësi, ka mundësi.... Banorët kanë marrë iniciativa vetë, kanë nxjerrë përfaqësues vetë dhe kur pamë që është bonusi qerasë aty menduam që është negociatë mes banorëve dhe Bashkisë Durrës dhe menduam pozitivisht te kjo gjëja. Dhe në shërbim të atyre banorëve menduam që do t'i vlejë ajo punë. Por nuk jemi në atë pikë akoma. Nuk jemi në atë pikën ku banorët kërkojnë bonusin e qerasë. Banorët kërkojnë anulimin e projektit. Dhe duke qenë se nuk jemi fare, nuk kemi pse të diskutojmë bonus qeraje.

Urdhëro tani, tani nëse ne, nëse ne do t'i hyjmë me themel këtij diskutimit sot për atë projekt futeni një përfaqësues dhe të shkojë mbledhja normalisht. Futeni more vëlla një përfaqësues. Nuk ka asnjë gjë të keqe këtu. Çfarë problemi ka? Çfarë problemi keni? Le të futet një mos fusin dy.

....Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...

Dritan Burgija : A ka mundësi? Në qoftë se nuk do ta fusni brenda, jemi të detyruar ta lejmë këtë mbledhje ta vazhdoni vetë.

....Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...

Zhuljeta Ngota: A mund të ma japësh fjalën?

Denisa Luarasi : Merre, thërri pak.

Zhuljeta Ngota: Unë një pyetje kam.

Ato stolat janë për qytetarët aty dhe ka të drejtë çdokush të vijë dhe të ndjekë çdo lloj mbledhje që bëhen këtu. Sot në këtë ditë që, ato qytetarët atje po protestojnë se është cënuar një pronësi, mos vijnë këtu dy apo tre, nuk e di domethënë, se si mund ta zgjidhin këtë, por aty duhet të jetë një përfaqësi. Ku qëndron problemi këtu? Nuk e kuptoj pse duhet të trembeni ju për këtë? Për çfarë arsye? Duhet të vijnë ato dhe ta dëgjojnë këtë, se ato janë të prekurit në mënyrë direkte

Luan Nezha :Dhe pastaj vazhdon mbledhja.

Zhuljeta Ngota:ose përndryshe do lëmë mbledhjen.

Denisa Luarasi: Okej, faleminderit.

Joniada Musaraj: Atëherë faleminderit kryetare.Me shumë peripeci me e marr fjalën, ndërkohë që flasim me mikrofon dhe pa mikrofon.

Unë kam një diçka që nuk shkon sot ka të bëjë me respektimin e rregullores nga ana juaj dhe ne të gjithëve bashkë që po i lejojmë të flasim anëtarët pa respektuar rregulloren. Në lidhje me shqetësimin unë dëgjova shumë, po mundohem të mbaj mend aq sa mundem. Në lidhje me rendin e ditës, zoti Burgija e pranoi dhe është e saktë ajo që ai thotë dhe që unë them që të gjithë kemi votuar pro për t'u përfshirë në rendin e ditës, nëse Burgija pretendon që ka kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, që normalisht dhe bashkia e ka kryetarja e bashkisë dhe të tjerët me radhë, patjetër që duhet ta dijë dhe nuk mund ta pretendojë sot që kjo pikë e rendit të ditës vjen si rezultat i një bashkëbisedimi, i bërë dje midis bashkisë dhe qytetarëve. Ne duhet të respektojmë rregulloren. Lexoni kryetare ju lutem rendin e ditës dhe kur të vijmë te pika që kolegët kanë komente pyetje, kanë të drejtën e gjithë botës që ta bëjnë. Mund të kem komente edhe unë, por të lutem të vazhdojë mbledhja dhe në pikën në momentin që vjen pika që kanë shqetësim anëtarët, janë të lirë të bëjnë komente dhe pyetje dhe patjetër ne do i përgjigjemi.

Në lidhje me problemin e parë që ju patët për rendin e ditës. Kështu që unë dua të kalohet kjo fazë e parë. Zoti Burgija unë dua të kalohet kjo fazë e parë.

Dritan Burgija: S' duhet të kalohet kjo fazë.....

Joniada Musaraj: Zoti Burgija të lutem.

Atëhere, atëherë kryesia, ne prandaj jemi që o e votojmë pro, o e votojmë kundër. Vota ka qenë pro dhe kjo pikë është rendi i ditës dhe nuk lëviz sot. Nga ana ime, unë jam anëtare kryesie dhe nuk pranoj që të hiqet nga rendi i ditës një pikë, që ka marrë votat pro e të gjitha e të gjithë anëtarëve të kryesisë.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit nënkryetare...

Joniada Musaraj: Lutem të kalojmë fazën e parë dhe pastaj.

Denisa Luarasi: Vazhdojmë me rendin e ditës. Pika 1...

Anisa Ibraj : Pa ardh qytetarët nuk vazhdon mbledhja.

.....*Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...*

Denisa Luarasi: Pika 1 "Për miratimin e kriterëve...."

.....*Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...*

Anisa Ibraj: O zonjë e nderuar, le të hyjnë dhe ata këtu, le të hyjnë dhe ata këtu se është e drejtë e tyre, është e drejtë e tyre të vijnë këtu, ju po i vidhni pronat.

.....*Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht...*

Rolant Xhelilaj: O Burgija të lutem, të lutem dëgjoni njëçik. Mua më pëlqen që shkoni mbas doktoreshës. Ka vlerë doktoresha te kjo pjesë. Ka vlerë, por, por ka një gjë...

Anisa Ibraj : Nuk ka kuptim mbledhja e Këshillit pa qytetarët.

Rolant Xhelilaj: Ulu, ulu..

Anisa Ibraj : Ato vendet janë për qytetarët. Nuk më thua ti mua të ulem. Vendet aty janë për qytetarët. Vendet aty janë për qytetarët. Nuk janë as për drejtorët e juaj. Janë për qytetarët aty vendet dhe të futen ata se është problematikë e tyre, nuk është problematikë e juaja.

Rolant Xhelilaj: Po, po, për qytetarët janë dhe i ke marrë ti përsipër.
O Burgija...

Anisa Ibraj : Po për qytetarët, si i vidhni ju pronat atyre.

Dritan Burgija: Anisa ka mundësi ta dëgjojmë zotin Xhelili se çfarë po thotë?

Edlira Shemsi: Jo, jo zoti Xhelili të bëj pyetje siç bëj unë

Dritan Burgija: Zoti Xhelili do të doja të dija qëndrimin e grupit tuaj para se të marrim vendimin.

Rolant Xhelilaj: Po pra po unë e thashë qëndrimin. Unë e thashë qëndrimin, unë e thashë qëndrimin po

Ardian Muka: Të futet një përfaqësues....

.....Flasin disa këshilltarë njëkohësisht dhe ngrihen në këmbë.....

Rolant Xhelilaj: O Xhuli, uli moj Xhuli ulu, kur fole ti unë ndenjta ulur, nuk u çova në këmbë. Edhe kur flas unë ulu. Ulu dhe dëgjo.

Dritan Burgija: Po na futni pra një përfaqësues.

Rolant Xhelilaj: Prit pra, ti dhe Muka, ngaqë nuk e di ndjeheni në vështirësi, nuk dëgjuat deri në fund që ju thashë. Pika 13 ka një diskutim që ne,

.....Flasin disa këshilltarë njëkohësisht

Rolant Xhelilaj: O Hekuran, të lutem Hekuran, të lutem.

Pika 13 ka një ngërcë thash, që ne si kryesi e kaluam me mirëkuptim, sepse e menduam dhe ne si ju pozitivisht. Ama dimë dhe një gjë tjetër që s'ka lidhje fare me projektin, dhe gjithë kjo lloj lufte

është sa për tu duk që të marri dhe televizioni një gjë. Po pra dhe ju thamë te pika 13 e diskutojmë pastaj edhe e fusim përfaqësuesin.

.....*Flasin disa këshilltarë njëkohësisht*

Rolant Xhelilaj: Ne shiko, kjo teoria të futet tashi nuk pinë ujë.

Të paktën, të paktën nga përvoja Muka dhe dikush tjetër e di që përfaqësuesi hyn kur është pika e tij.

Dritan Burgija: Po ç'a rëndësie ka se kur hyn.

Ai le të vi, të na jap informacion kur të jetë, tashi të rri aty ul.

Rolant Xhelilaj: Po le të vijë...

Denisa Luarasi: Atëhere të thërrasim....

Rolant Xhelilaj: Na thoni vetëm emrin...

Denisa Luarasi: Të thërrasim Entela Kojën të jetë e pranishme në mbledhje. Një nga administrata ta thërrasë.

.....*Flasin disa këshilltarë njëkohësisht*

Denisa Luarasi: Vetëm ju lutem, Entela Koja një nga administrata, Nikola të lutem.

Entela Koja të futet. Vetëm Entela Koja të futet.

.....*Flasin disa këshilltarë njëkohësisht*

Rolant Xhelilaj: Shiko atë, atë që bëni zhurmë ju, Entela Kojës i kam thënë që mbledhjen e kaluar. Motra hajde atje në mbledhje dhe trajtoje problemin atje.

Denisa Luarasi: Vazhdojmë me rendin e ditës.

Rolant Xhelilaj: Mos i fry njerëzit kot.....

Tashti ju bëni teatër, bëni.

Denisa Luarasi: Ju lutem vazhdojmë **me rendin e ditës**.

.....*Vazhdojnë flasin njëkohësisht disa këshilltarë në sallë mbi fillimin e mbledhjes*.....

Denisa Luarasi: Vazhdojmë. Pika 1 “Për miratimin e kriterëve..., të lutem...

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR
---------	--

.....Flasin disa këshilltarë njëkohësisht

Denisa Luarasi: Pika dy....

Pika 2.	PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE, QË KËRKOJNË TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL
Pika 3.	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT, TË PASHPËRNDARA NË VITIN 2025, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2026

Ju lutem pak qetësi në sallë. Doktoresha !.....

Pika 4.	PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 50, DATË 21.05.2024, “PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUNDI I RI, TË PASURISË ME NR.101/2, E LLOJIT TRUALL, ME SIPËRFAQE 1664M ² , ME VENDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 3541”
Pika 5.	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 473320.05 (KATËRQIND E SHTATËDHJETË E TRE MIJË E TREQIND E NJËZETË PIKË ZERO PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET”, PËR RRUGËN “ÇEL ISLAMI”
Pika 6.	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 939,836,189.3 (NËNTËQIND E TRIDHJETË E NËNTË MILION E TETËQIND E TRIDHJETË E GJASHTË MIJË E NJËQIND E TETËDHJETË E NËNTË PIKË TRE) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “LIDHJA E CURRILAVE ME RRUGËN “A. GOGA”
Pika 7.	RAPORT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË BASHKISË PËR VITIN 2025
Pika 8.	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE, QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT QË DO TË AKORDOHET NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT NË FAVOR TË BASHKISË DURRËS PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR VITIN 2026
Pika 9.	PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR TRAJTIMIN E GRAVE/VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE TË PAJISUR ME URDHËR MBROJTJE, ME STREHIM TË MENJËHERSHËM

Pika 10.	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR. 66, DATË 11.11.2025 “PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MËNYRËN E APLIKIMIT “PËR IMPLEMENTIMIN E SKEMËS: GRANTE PËR TË RINJTË NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE EKONOMIKE LOKALE”
Pika 11.	PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NGA GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025
Pika 12.	PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDESKRYETARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK
Pika 13.	PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET PËRFITUESE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I ZONËS PERSPEKTIVE TID, ME VENDNDODHJE NË PARKUN ARKEOLOGJIK DURRËS”

Keni ndonjë koment për rendin e ditës?

Kemi menduar që sot ta bëjmë votimin në mënyrë elektronike.

Kalojmë në votim.

Atëherë me 29 vota pro miratohet rendi i ditës.

Dorina Milja: Shiko se ka dhe kundra.

Denisa Luarasi: Po mirë 29 pro dhe 9 kundra. Ok.

Dritan Burgija: Ka mundësi, a ka mundësi....

Denisa Luarasi: I jepet fjala për projektvendimin e pikës 1, Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës...

Dritan Burgija: A ka mundësi të marr pak fjalën, se ndërkohë që ne flasim, atje po shoqërohen njerëzit në polici. Tani, ne do bëjmë një mbledhje normale sot apo do vazhdojmë me këtë llogjikën tuaj që njerëzit protestojnë për drejtat e tyre dhe ju i çoni në polici.

Do vazhdojmë, do bëjmë ndonjëherë një bisedë normale në këtë vend.

A ka mundësi të ndërhyri? Keni të gjitha mundësitë ato çunat që kanë marrë sot policia të dalin tani! Ka mundësi të ndërhyri apo do ta kthejmë mbrapsht sot këtë sallë? A ka mundësi të merreni me këtë punë?

Llesh Çuni: Negocioni ju se ne ramë dakort që tek pika do të hyjnë.

Dritan Burgija: Ça do negocjojmë ne? Ça do negocjojmë ne?

Denisa Luarasi: Tani, tani Burgija të lutem, a do vazhdojmë me mbledhjen ?.

Dritan Burgija: A ka mundësi po të them, se po na ktheni mbrapsht.

Rolant Xhelilaj: Po kërkon një gjë që

Dritan Burgija: Çfarë po kërkoj, po kërkoj një gjë që po bëni ju, një gjë të jashtëllogjikshme komplet. Po protestojnë për një gjë të tyre.

Denisa Luarasi: Burgija ne jemi në mbledhje këtu.
Burgija ne jemi këtu në mbledhje. Të lutem, vazhdojmë me mbledhjen.

Dritan Burgija: Jo. Shiko që nga dita e parë...

Denisa Luarasi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonja Joniada Musaraj. Po

Dritan Burgija: Dëgjo, a ka mundësi të, a ka mundësi që kjo të zgjidhet me urgjencë? Sepse ne do të shkojmë atje dhe do të bashkohemi me ato banorë dhe pastaj t'i dali tymi kësaj pune. A ka mundësi t'i jepni zgjidhje kësaj pune apo jo?

Joniada Musaraj: Të vazhdoj?

Dritan Burgija : Jo jo, mos vazhdoni.

Joniada Musaraj: Atëherë zoti Burgija, fjalën s'ma heq ti zoti Burgija. Pse nuk reagoje zoti Burgija kur u kap Fred Mullaraj për dore? Kështu që unë jam më e qetë se ju.

Dritan Burgija: Nuk jemi acaru naiherë në këtë farë feje. Nëse nuk dalim tashi në urgjent nga birucat ku i keni fut tashi kjo sallë kthehet mbrapsht.

Joniada Musaraj: Nuk jam policia e shtetit.
Kujdes pak me tonin e zërit e para, kështu që e dyta po të them nëse e ke kaq për zemër të na mbrosh ne si anëtar, të kishe reaguuar kur kolegu jonë është kap për rrobash mes bulevardit. Kështu që, në qoftë se e do këtë përgjigje. Vazhdojmë të lutem.

Dritan Burgija: A ka mundësi t'i jepni zgjidhje.

Denisa Luarasi: Vazhdojmë me mbledhjen Burgija.

Joniada Musaraj: Nuk e kam me qytetarët fare, e kam me ju drejtpërdrejt.

Denisa Luarasi: Jemi në Këshill Bashkiak këtu dhe nuk kemi lidhje me policinë fare, kështu që vazhdojmë.

.....Entela Koja (*përfaqësuesja e qytetarëve*): *flet nga vëndi ku ishte ulur*.....

Joniada Musaraj: Atëhere Komisioni për Çështjet...

Komisioni për Çështjet Ligjore e miratoi pikën e parë dhe e fton Këshillin të votojë pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Joniada Musaraj.

..... *Entela Koja vazhdon flet nga larg*

Denisa Luarasi: Zonja Koja, zonja Koja, ju lutem, ju futem në sallë mos...

.....*Flasin njëkohësisht në sallë qytetarja dhe këshilltarë*.....

Denisa Luarasi: Zonja Koja, ju lutem.

.....*Flasin njëkohësisht në sallë qytetarja dhe këshilltarë*.....

Flutura Kola : O Entela nuk po flasim për pikën 13. Ulu, kur të flasim për pikën 13.

Dritan Burgjia: Ja ku i keni, ja ku i keni. Ja ku i keni. (...*tregon celularin*)

Denisa Luarasi: Burgjia, të lutem ulu Burgjia, ulu pak të lutem.

Dritan Burgjia: Media ja ku i keni duke arrestu njerëzit. Ja ku i keni.

Denisa Luarasi: Burgjia, vazhdojmë me mbledhjen të lutem.

Joniada Musaraj: Ajo ka drejtën e gjithë botës dhe përfaqëson qytetarët. Ju ku ishit deri më sot? Ju ku ishit....

.....*Flasin disa këshilltarë njëherësh në sallë*.....

Denisa Luarasi: Shemsi ulu të lutem. Burgjia të lutem, Burgjia ulu në vend të lutem, ulu vazhdojmë me mbledhjen. Burgjia të lutem, të lutem ulu në vend.

Dritan Burgjia: Nuk vazhdon mbledhja pa dal këto.

.....*Flasin njëkohësisht këshilltarë dhe qytetarja Koja*

Denisa Luarasi: Zonja Koja.....

.....*Flasin njëkohësisht këshilltarë dhe qytetarja Koja*

Denisa Luarasi: Po, vazhdo Flutura.

Flutura Kasa: Entela ulu se jam me ju, ulu mos na e prish mbledhjen.

Denisa Luarasi: Entela të lutem ulu në vend, të lutem Entela. Të lutem ulu mos na detyro t'ju nxjerr jashtë. Ulu të lutem mos na prishni mbledhjen.

Flutura Kasa: Ulu aty të vazhdojmë mbledhjen.

Denisa Luarasi: Të lutem....

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zonja Edlira Shemsi.

Dritan Burgija : Ne sot bashkohemi me ata....

Edlira Shemsi: Çfarë të flas. Me të nxjerrë në rrugë, ku ka diskriminim më të madh se sa me të marrë pronën e me të nxjerrë në rrugë, ku ka diskriminim më të madh, diskriminimi i drejtës së pronës.

.... *Flasin disa këshilltarë njëherësh*

Denisa Luarasi: Eda je dakort?

.... *Flasin disa këshilltarë njëherësh*

..... *Këshilltarë të pakicës në sallë fillojnë dalin nga salla*

Flutura Kasa: A e sollëm përfaqësuesin? A e futëm brenda? Ça doni?

Joniada Musaraj: Atëhere më dëgjoni pak. Po largoheni në pikën 1, që flet për ndihmën ekonomike. Në qoftë se jeni për qytetarët voto pro pikës 1.

Dritan Burgija: Ju ftojme të bashkoheni dhe ju.

Joniada Musaraj: Jemi te pika 1, për ndihmën ekonomike.

S'ka lidhje fare, fare, fare, aspak me projektin.

Jo, jo, jo, jo. Votoni pro ndihmës ekonomike. Votoni pro ndihmës ekonomike. Jemi te pika e parë e rendit të ditës.

.....*Flasin disa këshilltarë njëherësh*

Denisa Luarasi: Zonja Edlira Shemsi, ty s'të takon të largohesh. Zonja Edlira Shemsi, ty s'të takon të largohesh për ndihmën ekonomike.

Joniada Musaraj: Atëherë , Kryetare....

Denisa Luarasi: Për ndihmën ekonomike.

.....*Flasin disa këshilltarë njëherësh*

Joniada Musaraj: Zoti Xhelilaj.

Hekuran Markola : A ka kuorum?

Denisa Luarasi: Ja ta shohim..

....*Flasin disa këshilltarë në sallë njëkohësisht*

Joniada Musaraj: Atëherë , Kryetare, të lutem...
Zoti Xhelilaj,..... të lutem je dhe pa mikrofon.

....*Flasin disa këshilltarë në sallë njëkohësisht*

Denisa Luarasi: Landi, zoti Xhelilaj, mund t'ia japim fjalën zonjës Koja të parashtojë kërkesat? Zonja Koja? S'ka problem.

Joniada Musaraj: Zoti Xhelilaj. Zoti Xhelilaj të lutem, sepse je...

Denisa Luarasi: Mund të parashtojë kërkesat zonja Koja?

Joniada Musaraj: Jo kryetare s'mund t'i parashtoj kur jemi te pika e parë e rendit dititës. Jo të lutem të votohet ndihma ekonomike meqënëse...

Hekuran Markola : Nuk kemi kuorum, u mbyll mbledhja.

Joniada Musaraj: Jam dakort të merret vesh dhe nga media dhe nga qytetarët që minoranca, opozita del nga salla dhe nuk voton ndihmën ekonomike. Rendi i ditës.....

Edlira Shemsi: Jemi në sallë.

Joniada Musaraj:Patjetër ju respektoj dhe shumë faleminderit që po qëndroni. Këshilli nuk funksionon dhe nuk po merr vendimmarrje vetëm për projektin TID dhe të anashkalojmë të gjithë pikat e tjera, që janë shumë të rëndësishme. Jemi te pika e parë.

Edlira Shemsi: Zonja kryetare do të ma japësh fjalën apo jo?

Denisa Luarasi: Po e ke.

Joniada Musaraj: Zonja ka të drejtë të flasi kur t'i vijë rradha. Të lutem.....

Edlira Shemsi: Si kryetare e Komisionit për Çështjet Sociale kundër Diskriminimit dhe Barazisë Gjimore është kaluar ndihma ekonomike për muajin vazhdim nga komisioni me shumicë votash dhe i referohet Këshillit për miratim. Ky komision ka emrin kundër diskriminimit. Diskriminim më të madh si t'i marrësh pronën tjetrit, ta nxjerrësh nga shtëpia nuk ka. Juve që do jepni bonus qiraje për ata njerëz që s'kanë bërë asnjë kontratë me ju, keni dy vjet e gjys që nuk kemi bonus qeraje për ata të tërmetit që nga pensionet e veta. Sa për ndihmën ekonomike është miratuar ato 100 familje, se kaq e keni takatin ju.

Denisa Luarasi: Ta kalojmë në votim.

Edlira Shemsi: Sepse ajo ndihma ekonomike i jepet pa nxjerrë akoma dhe tani që flasim sa është minimumi jetik. Vazhdoni miratojeni ato 100 familje se kaq e keni takatin ju.

Joniada Musaraj: Opozita sot i ka hequr të drejtën përfaqësueses ... jo, jo të thuhet gjërat siç janë.

Denisa Luarasi: Zonja Harizi, nuk do ta votosh?

Kalojmë në votim.

Joniada Musaraj: Prit. Edhe njëherë. Prit vetëm një diçka. Sot opozita e ka hequr të drejtën përfaqësueses së qytetarëve duke dalë nga salla dhe duke hapur probleme për kuorumin që të diskutohen ato çështje të rëndësishme që ata kishin. Zonja, zonja Koja, ta jap këtë, ta jap si këshillë dhe të dish që kur ka qenë votimi për shpronësimet, nuk e di nëse i ke dëgjuar çfarë kanë thënë, kështu që kur të vijë patjetër...

...Qytetarja Koja flet nga larg për komision hetimor....e kemi dorëzuar.....

Joniada Musaraj: Komisioni hetimor...

Denisa Luarasi: Të lutem....

Joniada Musaraj: T'jua sqaroj

Entela Koja: Janë të regjistruar...

Joniada Musaraj: T'jua sqaroj si juriste, sipas rregullores zonja Koja. Po të sqaroj një diçka që do të shërbejë ty.

.....*Qytetarja Koja flet pa mikrofon*

Joniada Musaraj: Po të sqaroj një diçka që do të shërbejë ty, do të shërbejë ty....po ta jap si informacion komisioni hetimor ngrihet nga anëtarët e këshillit

Dorian Isaj: Vazhdojmë me pikën Jonada.

.....*Qytetarja Koja flet pa mikrofon*

Joniada Musaraj: Më lër ta them një fjali. Komisioni hetimor kërkohet nga anëtarët..

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim. Të lutem shumë

.....*Flasin shumë këshilltarë dhe qytetarja njëkohësisht.....*

Denisa Luarasi: Zonja Meçi, po.

Klementina Meçi: Ju lutem, ju lutem, atëherë o zonjë, o zonjë se ka një gjë domethënë ka një nonsens shumë të madh në gjithë këtë histori. E fillojmë mbledhjen, kërkojmë përfaqësuesin. Shumë bukur. Mbrëmë në darkë se lexova, thotë ai. E shkruajta okej. Po tani sot mëngjes nuk është më okej. Kam përshtypjen, kam përshtypjen se nuk zgjidhen gjërat duke ngritur zërin. Gjërat zgjidhen duke e shfrytëzuar sallën e Këshillit Bashkiak dhe duke ardhur këtu me argumenta. Dhe për më tepër, dhe për më tepër ju lutem hapni sytë ato që bëjnë sikur ju fusin në sallë. Ato prishin kuorumin këtu edhe ne as nuk vazhdojmë dot më mbledhjen. Nuk e di se kush ju dëgjon juve. Nuk e di kush ju dëgjon. Shfrytëzohesh dhe dëgjohesh janë shumë të ndryshme me njëra-tjetrën. Dalloni se kur shfrytëzoheni dhe kur dëgjoheni.

.....*Flutura Kasa dhe Entela Koja flasin në sallë njëkohësisht.....Flutura i kërkon qytetares të pushoj dhe të lërë të vazhdojë mbledhja.....*

Joniada Musaraj: Kalojmë këto që kemi, pika e parë, ishim te pika e parë e rendit të ditës, ne këtë po themi.

.....*Flasin shumë këshilltarë dhe qytetarja njëkohësisht.....*

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim për pikën 1 të rendit të ditës.

.....*Flasin shumë këshilltarë njëkohësisht.....*

Denisa Luarasi: Meqë nuk ka kuorum shtyjmë mbledhjen 5 minuta sa të futen në sallë dhe këshilltarët që kanë ngelur jashtë.

.....rifillon mbledhja

Denisa Luarasi : Fillojmë mbledhjen
Sekretarja të bëj dhe njëherë prezencën.

Dorina Milja: Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri....
27 këshilltarë në sallë.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, rilexojmë dhe njëherë projektvendimin **e pikës 1**.

- I jepet fjala Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, ndjesë dhe njëherë për pikën 1? Sepse nuk u mbyll si procedurë. Atëherë për pikën e parë komisioni ynë e miratoi me shumicë votash dhe fton Këshillin të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Barazisë Gjimore Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zoti Denis Lika.

Denis Lika: Komisioni jonë u mblodh dhe me shumicë votash e propozon për Këshill që të kalojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Lika.

Kalojmë në votim, komente kemi? S'kemi.

Kalojmë votim.

Me 27 vota pro, kalohet pika 1 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 2** të rendit të ditës Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetare dhe në lidhje me pikën 2 komisioni ynë me shumicë votash i dha votën pro dhe ftojme këshillin që ta miratojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni Strehimit dhe Shërbime Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike e kalon sot për miratim pikën 2 në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje ka? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Me 27 vota pro, kalohet pika 2-të e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 3, komisioni ynë votoi me shumicë votash për pro dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Strehimit Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Merre fjalën të lutem.

Marsida Feshti: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike kalon pikën 3 për miratim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komisioni i Buxhetit i Financës dhe Taksave Tarifave, Zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Edhe komisioni jonë e kalon këtë pikë për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente, pyetje ka për **pikën 3** të rendit të ditës? Nuk ka.

Kalojmë votim.

Me 27 vota pro kalon dhe pika 3 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 4 kryetare e ftojmë Këshillin të japi votën pro pasi u miratua në komisionin tonë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.

Komisioni i Pronave Publike me shumicë votash e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komente, pyetje kemi për pikën 4 të rendit të ditës? Nuk ka.

Kalojmë votim.

Me 27 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 5** të rendit të ditës Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 5 komisioni ynë e votoi pro dhe ftojmë Këshillin që t'i japi votën pro. Faleminderit.

Densia Luarasi: Faleminderit nënkryetare.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe për pikën 5 të rendit të ditës, komisioni ynë e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

E merr fjalën Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje.

Dhe komisioni jonë me shumicë votash ja propozon Këshillit për miratim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Mamo.

Komente, pyetje kemi? Nuk ka.

Kalojmë votim.

Me 25 vota pro, 2 abstenim.

Pika e pestë, si?

Hekuran Markola: Pa dashje....

Denisa Luarasi: Tani pa dashje, s'ka lojë këtu, lojë s'jemi në lojë, ju lutem pak seriozitet, pak seriozitet. Mund ta shprehim me kartë meqë po dëgjoj që po thoni pa dashje.

Atëherë kush është pro për pikën 5 të rendit ditës?

Atëhere me 27 vota pro miratohet pika 5 e rendit ditës.

Ju lutem telefonat mos përdoren gjatë votimit. Pak respekt dhe seriozitet.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 6**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë dhe për pikën 6, ne kemi dhënë votën pro si komision dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Edhe për pikën 6 të rendit të ditës kemi dhënë votën pro si komision e kalojmë për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Edhe komisioni jonë e miratojë me shumicë votash dhe ja kalon Këshillit si propozim sot për miratim. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Komente pyetje kemi për pikën gjashtë të rendit ditës? Nuk ka.

Vazhdojmë në votim elektronik.

Atëhere me 27 vota pro miratohet pika 6 e rendit ditës.

Po znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Kam vetëm një propozim kryetare nëse e marrin parasysht dhe anëtarët.

Pika 7, që ka lidhje me raportin për punën e Këshillit të Bashkisë, propozoj që të lihet si pikë e fundit të konsumojmë gjithë pikat e tjera dhe pastaj nëse....

Nuk e di sa kanë përgatitur.

Dorina Milja : Jo nuk është shumë, në mënyrë të përmbledhur.

Joniada Musaraj: Okej. Okej. Në rregull. Mirë.

Po dhe gjysfaqe në fund nuk prish punë. Okej.

Denisa Luarasi: Faleminderit për sugjerimin. Po, po e lexojmë në mënyrë të përmbledhur.

Juve e keni lexuar besoj. **Pika e 7** është raporti, puna e këshillit.

Të nderuar këshilltarë !

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi mbledhjet e këshillit, mbledhjet e komisioneve, vendimet e marra dhe konsultimet publike.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role duke u bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Nga karakteri i vendimeve mund t’i ndajmë në:

- | | |
|--------------------------------------|--------------|
| 1. për problematika financiare | - 11 vendime |
| 2. për probleme sociale | - 14 vendime |
| 3. për infrastrukturën dhe strehimin | - 25 vendime |
| 4. për problemet urbane dhe asetet | - 13 vendime |
| 5. për emergjencat civile | - 3 vendime |
| 6. për probleme të arsimit kulturës | - 4 vendime |
| 7. të ndryshme | - 12 vendime |

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin. Ky dominim lidhet drejtëpërdrejtë me faktin se çështjet për strehimin dhe

infrastrukturën përfaqësojnë nevoja themelore dhe prioritare për komunitetin, veçanërisht në kontekstin e proceseve të rindërtimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.

Për vendimet e marra nga ky këshill për 12 mujorin e vitit 2025 institucioni i *Prefektit të Qarkut Durrës* është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre për 48 akte normative, 38, më fal 33 është shprehur se janë akte individuale dhe për 1 vendim është shprehur se nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak, por e Kryetarit të Bashkisë.

Gjatë vitit 2025, dy këshilltarë humbën mandatin për shkak të zgjedhjes si deputetë në Kuvendin e Shqipërisë të 11 maj 2025: Ani Dyrmishi – zëvendësuar nga Kastriot Xhongoli (nga e njëjta listë partiake) dhe Manjola Luku – zëvendësuar nga Mirela Shala (nga e njëjta listë partiake). Këto zëvendësime u miratuan nga Këshilli në mbledhjen e shtator dhe nëntor 2025, pas propozimit të Komisionit të Mandateve.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka mbajtur 9 mbledhje të radhës (1 mbledhje e radhës është shtyrë), 4 mbledhje jashtëradhe dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të jashtëzakondshme. Numri total i mbledhjeve plenare të mbajtura: 13 (duke llogaritur 3 në korrik, pra duke përfshirë dhe atë që u shty). Pjesëmarrja mesatare në sallë: rreth 35.5 këshilltarë për mbledhje. Shumica e mbledhjeve kanë qenë midis 65-80 % të pjesëmarrjes (duke përfshirë atë që u shty). Pjesëmarrja mesatare në përqindje: 69.6%. Më e larta: 80% (mars) me 41 këshilltarë. Më e ulëta: 45% (korrik, ajo që u shty) me 23 këshilltarë.

Komisionet e përhershme të këshillit për periudhën 12-mujore kanë mbajtur 68 mbledhje.

Mbledhjet janë mbajtur në Sallën e Këshillit apo Zyrën e Sekretarisë së Këshillit .Gjatë 12 mujorit janë dorëzuar 88 raporte apo pocesverbale të mbajtura nga këto komisione. Nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e bashkisë Durrës pak sekonda kam

Në zbatim të Programit të Transparencës dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore për informimin e publikut, Këshilli Bashkiak Durrës ka përditësuar dhe strukturuar faqen e tij zyrtare online, duke garantuar akses të gjerë, të lehtë dhe të vazhdueshëm të qytetarëve në informacionet që lidhen me organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Këshillit Bashkiak.

Gjatë periudhës 12-mujore të këtij viti, Këshilli Bashkiak Durrës, në bashkëpunim të ngushtë me administratën e Bashkisë, ka garantuar zhvillimin e proceseve të konsultimit publik, për pika të veçanta të rendit të ditës, si plani social, plani i arsimit parauniversitar, buxheti, taksat, paketa e maleve..etj.). Po kaloj tek detyrat tona...

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative, të cilat do të diskutohen dhe vendosen në Këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të. Të garantojnë që komentet e publikut të merren parasysh në vendimarrje. Të kontribuojnë në informimin e qytetarëve për të drejtën e tyre për t'u konsultuar dhe për mënyrat e pjesëmarrjes.

Po e mbyll. Ju uroj punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit tuaj gjatë vitit 2025! Keni ndonjë sugjerim për përmirësimin e punës së këshillit?..... Nuk keni.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 8**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 8, ne si komision i dhamë votën pro dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetare.

E merr fjalën Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort që të kalojë për miratim në Këshill pika 8.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit Denis Lika.

Denis Lika: Edhe për këtë pikë komisioni jonë e votoi me shumicë votash dhe fton Këshillin që ta kalojë atë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Lika.

Komente, pyetje kemi për pikën 8 të rendit të ditës? Nuk ka.

Kalojmë votim elektronik.

Me 27 vota pro kalon dhe pika 8 e rendit ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 9**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 9, ne si komision i dhamë votën pro dhe ftojmë Këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetare.

E merr fjalën Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që të kalojë për miratim në Këshill.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit Denis Lika.

Denis Lika: Edhe për këtë pikë komisioni jonë votoi pro dhe propozon për kalimin e saj.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Lika.

Komente, pyetje kemi për pikën 9 të rendit ditës.

Flutura Kasa: Kam unë.

Denisa Luarasi: Po, zonja Kasa.

Flutura Kasa: Kjo është një ndër pikat më të ndjeshme dhe falenderoj kushdo që e ka përgatitur këtë pikë dhe ishalla na del me sukses që vërtetë gratë e dhunuara të strehohen në mënyrë të menjëhershme. Është një ndër pikat më delikate.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Kasa.

Kalojmë votim elektronik.

Me 27 vota pro kalon dhe pika 9 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 10**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën 10, ne si komision i dhamë votën pro dhe ftojme Këshillin që ta miratojë sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetare.

E merr fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit zoti Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli: Edhe ne si komision me unanimitet të plotë kemi rënë dakord për të kaluar për votim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhongoli.

E merr fjalën Komisioni i Politikave të Zhvillimit Ekonomik zoti Dorian Isaj.

Dorian Isaj: Edhe ne si komision vendosëm ta kalojmë këtë pikë.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.

Komente, pyetje kemi për pikën 10 të rendit të ditës?Nuk ka.

Kalojmë votim elektronik.

Me 27 vota pro kalon dhe pika 10 e rendit i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 11**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe pikën 11, ne e votuam si komision dhe kërkojmë nga Këshilli që të japi votën pro. Faleminderit.

Densia Luarasi: Shumë faleminderit zonja nënkryetare.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit. Financës, Taksave - Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon këtë pikë në Këshillin Bashkiak për votim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhelilaj.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të nderit, zoti Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli : Edhe për këtë pikë me shumicë votash kalon në Këshill për miratim.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhongoli.

Komente, pyetje kemi për pikën 11 të rendit dritës?... Nuk ka.

Kalojmë votim.

Me 27 vota pro, kalon dhe pika 11 e rendit i dritës.

Dorina Milja: Për pikën 12 kanë sjellë propozimin opozita.

Denisa Luarasi: **Për pikën 12** kanë sjellë propozim.

Po, po zoti Rolant Xhelilaj po.

Pra përse i përket pikës 12 për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak, po na kanë sjellë me shkresë propozim për zonjën Mirela Shala.

E merr fjalën z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Faleminderit zonja kryetare.

Funksionimi normal i Këshillit Bashkiak është i plotë kur përveç kryetares janë dhe dy nënkryetarë të Këshillit. Në mbledhjen e kaluar që ne miratuam nënkryetarin e Këshillit Bashkiak, grupi opozitar nuk kishte propozim konkret dhe e shtymë për këtë mbledhje. Duke qenë korrekt me rendin e dritës dhe me qëndrimin tonë si grup, pavarësisht se në votimin e radhës së kaluar për nënkryetarin e Këshillit Bashkiak që është e drejtë e Partisë Socialiste, opozita votoi kundër, unë ftoj grupin të votojmë pro kandidaturës të paraqitur nga opozita, sepse është kandidaturë që u takon atyre për drejtimin normal të Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit.

Po, po si procedurë.

Po, znj. Kasa.

Flutura Kasa: Unë votoj kundër, sepse nuk është ajo zonja më e mirë se këto dy koleget tona.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kasa.

.....Flasin njëkohësisht disa këshilltarë

Denisa Luarasi: Po, zoti Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Me leje

Denisa Luarasi: U kthye humori. Ta dëgjojmë pak zotin Xhelilaj

Rolant Xhelilaj: Komenti i Flutrës është normal në qëndrimin individual, kurse në vendimet që merren është një nënkryetar i takon pozitës dhe një nënkryetar i takon opozitës. Se si është ajo, tjetër gjë.... a tani të lutem...

Llesh Çuni : Duhet ta votojmë....

Hekuran Markola: Unë nuk votoj njeri që nuk është prezent...

Rolant Xhelilaj: Komentin, komentin.....

Denisa Luarasi: E kanë bërë me shkrim, e kanë bërë kërkesën me shkrim.

Hekuran Markola: Duhet të jetë prezent që ta votojmë. Kaq.

Rolant Xhelilaj: Është problemi se Hekurani ka të drejtë se nuk e njef si paraqitje, do që ta shofi. Edhe njëherë, Hekuran të lutem.....

Denisa Luarasi: Unë propozoj, unë propozoj si...

Rolant Xhelilaj: Tutem ta mbaroj unë, ta mbaroj, ta mbaroj unë...

Kjo nuk është votë që ka lidhje me qëndrimin e njërit apo tjetrit, kjo është votë grupi dhe të gjithë...

Hekuran Markola: Nuk e njof unë.

Rolant Xhelilaj: Nuk ke pse ta njohësh pra, do ta njohësh kur dali aty tek tavolina.

Hekuran Markola: Jo mo jo, duhet të jetë ta votoj...

Rolant Xhelilaj : Ej, i ul vlerën vetes, i ul vlerën vetes tënde, po the që unë nuk e votoj se ja më ka ofenduar mua ajo. Ne këtu, ne këtu edhe përplasemi, por jashtë jemi të gjithë qytetarë.

..... *Flasin disa këshilltarë njëkohësisht*

Rolant Xhelilaj: Hekuran a ta mbaroj unë o burrë.

Denisa Luarasi: Tani për respekt, për respekt të kryetarit ta dëgjojmë.

Flutura Kasa: Dëgjo, të lutem. U votuan dy kolege. Ne jemi të gjithë të mirë përderisa kemi ardhur këtu....

Rolant Xhelilaj: Voto pro dhe mbylle këtë muhabet

Denisa Luarasi: Pak respekt për zotin Xhelilaj.
Ju lutem....

Rolant Xhelilaj: Na duhet. Ju bëni garipllikun kot tashi.

.....Disa këshilltarë flasin njëkohësisht.....

Rolant Xhelilaj: Shiko ky është qëndrim grupi e Hekurani do votojë pro për arsye, për arsye.....

Hekuran Markola: Jo une do votoj kundra.

Rolant Xhelilaj: Për arsye se, për arsye

Hekuran Markola: Po të ishte prezent do ta votoj pro, ta shikojmë kush është.

Rolant Xhelilaj: Hekuran, është kërkesa më pa kuptim që ekziston. Më sill atë të PD-së ta shoh që është simpatike apo jo. Duhet votuar pro si qëndrim grupi për t'ju dhënë atyre mesazhin që ne jemi ndryshe nga ata.

Denisa Luarasi: Po, jam dakord.

Rolant Xhelilaj: Një ndarje ligjore që një nënkryetar e ka pozita dhe një nënkryetar e ka opozita, qëndrimi i tyre duke mbështetur Flutrën, ishte votë kundër. Ne nuk jemi si ata, ne jemi PS që kërkojmë bashkëpunimin me të gjitha forcat politike që bëjnë pjesë këtu në Këshill Bashkiak dhe personi që ato vendosin është e drejta e tyre. Të jetë mashkull, të jetë femër, të jetë ku di unë shumë e bukur, të mos jetë e bukur është problem i grupit të opozitës. Prandaj edhe njëherë edhe Fluturën dhe Hekuranin i ftoj ta mendojnë votën dhe mos të bëjnë, mos bëjnë teatër kot këtu me një votë që është, që është votë qëndrim grupi. Nuk është votë që kërkohet opinioni i....

Hekuran Markola: Qëndrim grupi nuk është për opozitën.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhelilaj.
E ka marrë, e kërkon fjalën zonja Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë shumë shkurt, në fakt është e vërtetë që kur ne jemi votuar ju si kryetare dhe unë si nënkryetare ata nuk ishin, të jemi të sinqertë, opozita nuk kishte asgjë me emrat konkret, e kishte për procedurë, meqënëse nuk ishin gati dhe nuk kishin sjellë emrin për nënkryetar. Në fakt kryetari i grupit tonë ka të drejtë, sepse ne si grupim funksionojmë dhe kemi vendimmarrje grupi në çështje shumë më të rëndësishme, sesa në rastin konkret që në fakt është

e drejtë e tyre të sjellin emrin dhe e kanë bërë kërkesën me shkrim, kështu që dhe me procedurë është në rregull. Unë ftoj grupin tonë që ta votojë pro. Zonja është e nderuar dhe arsyeja kryesore është funksionimi i Këshillit siç duhet. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit nënkryetare.

Ju ftoj ta votojmë kandidaten Mirela Shalën si nënkryetare Këshillit Bashkiak.

Atëherë nuk kalon pika e 12.

Me 25 vota pro dhe 2 kundër nuk kalon pika e 12 e rendit ditës.

....Flasin disa këshilltarë njëherësh

Denisa Luarasi: Pak qetësi ju lutem.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 13**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëhere, kryetare më lejo vetëm të bëj një parantezë dhe pastaj nuk është pikë që kalon vetëm që komisioni votojë pro apo kundër. Është e vërtetë që në mbledhjen tonë si komision ne e kemi miratuar, por unë në fakt do të doja dhe opinionin dhe mbështetjen e kryetarit të grupit tonë që dhe me situatën që ndodhi sot, meqënëse kemi prezent dhe përfaqësuesen e qytetarëve, që të jem e sinqertë, jam më e lumtur të dëgjoj përfaqësuesen e qytetarëve sesa kolegët opozitarë, të cilët nuk lënë rast pa e shfrytëzuar për retorikë politike. Kështu që në rastin konkret unë dua të tregohem dhe të tregoj të vërtetën se çka ndodhur, por duhet të marrim parasysh dhe zhvillimet aktuale, kështu që... Shumë faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja nënkryetare.

Po zonja Koja.

Entela Koja: Përshëndetje të gjithëve.

Atëherë, oponenca jonë e madhe për këtë kalimin e bonusit të qirasë, domethënë po e nis nga fundi, po ju shpjegoj dhe disa të tjera në vazhdim, është pikërisht për faktin që, ka kaluar një vendim në mënyrë arbitrare nga shefja e urbanistikës me 3.2.2024 kur pronat nuk janë shpronësuar akoma. Vërtetë VKM-ja 477 i shpronëson këto, domethënë i çon për shpronësim vendimi i Këshillit të Ministrave dhe projekti i TID, 74 familje, por ata janë në proces jo thjesht gjyqësor, por në proces negociimi katër palësh. Bashki Durrës, Ministri Kulture, AADF dhe ne pikërisht për të korrigjuar gabimet që janë bërë. Ne nuk po themi që jemi kundër projektit, të korrigjohen gabimet që janë bërë. Tashi në vend që të ndodhi kjo mbas takimit që u kërkuar katër palësh, por në fakt u bë tre palësh dhe këtë e kemi konfirmim nga ADF-ja pa prezencën tonë, fillojnë raprezaljet. Njerëzve atje i merren librezat e ujit, të korrentit, i kërkohet emri dhe i thohet do të çonin për bonus qeraje. Tashi, kur ky vendim vjen këtu te ju e kuptoni se çfarë, se çfarë efekti ka ke ata njerëz. Sot i ka ardhur në bazë të këtij vendimi që ka nxjerrë shefja e urbanistikës, kur pronat tona janë akoma në emrin tonë, sepse s'kanë mbaruar procedurat e shpronësimit. Ka një procedurë në Ministrinë e Infrastrukturës pikërisht te ASSH-ja, te Agjencia e Shpronësimit ka

një procedurë për shpronësimin. Disa e kanë bërë, ata që janë në procese gjyqësore kundër projektit dhe kundër mënyrës se si projekti ka vepruar mbi ta. Ndër to edhe kisha ortodokse, kisha katolike edhe komuniteti mysliman, të cilët i merren prona në shkelje të Kushtetutës, sepse Kushtetuta e Shqipërisë dhe memorandumet bashkëpunimi, që ka memorandumet me shtetin shqiptar asnjë pronë e komunitetit fetar nuk merret pa pëlqimin e tyre. Pra, kemi gafa të rënda në projekt, kemi gafa të cilat ne kemi gjashtë muaj që po ju themi i kemi konstatuar. Megjithatë në vend ADF-ja na u përgjigj dhe tha do bëjmë katër palëshe. Ju ka ardhur letra këtu, ju ka ardhur me firmë nga mbi 1500 banorë të qytetit të Durrësit, ju ka ardhur firma nga mbi 45 banorë të prekur nga projekti ku thonë : ..“Nuk kemi asnjë dizeni deri ditën që na erdhi shpronësimi”...

Hekuran Markola: A mund të më sqarosh mua qartë si këshilltar?

Ku është fajti i Këshillit Bashkiak në këtë mes?

Entela Koja: Po nuk po flas për Këshillin Bashkiak more zotni tani.

Unë po ju them për këtë vendimin që do bëni tani, bonusin që....

.....Hekurani flet njëkohësisht me qytetaren.....

Entela Koja: ...Po nuk është, nuk është fajti juaj që nuk i keni ditur të drejtat e juaja.

.....Hekurani flet njëkohësisht me qytetaren.....

Entela Koja: Ta jap unë, sipas ligjit të urbanistikës, ta referoj dhe ligjin dhe shikoheni më vonë. Ligji numër 107/ 2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 12, Këshilli Bashkiak ka të drejtë për të miratuar nismën për hartimin apo rishikimin e planit të përgjithshëm vendor dhe të detajuar vendor. Në raste kur ka gabime të konstatueshme si këto që po themi ne, ju e keni tagrin, ta pezulloni dhe futeni mbas një muaji, futeni mbas 15 ditësh, sepse ajo leje që është miratuar, është miratuar me gabime të rënda, të konstatuara. Tashi çfarë ju pengon ju ta bëni këtë? Megjithatë, ne jemi në këtë procesin e, po themi gjetjes së të drejtës tonë edhe ligjërisht, por miratimi i bonus të qerasë dhe çuarja e IKMT-së, letrës së IKMT-së sot dhe pikërisht atyre të cilët e kanë çuar bashkë kundërshtimin kundër projektit, 14 banorë, jo ata që kanë apo shohin vlerën që nuk pajtohen me vlerën apo ata që e kanë marrë, ne nuk përfaqësojmë ata. Ne po përfaqësojmë aty ku është bërë gabimi në projekt dhe t'i çosh pikërisht atyre të parëve vendimin e prishjes, i bjen që e ke me ata. E ke pikërisht me ata, por je ndërkohë në shkelje ligjore, je ndërkohë kur institucionet po punojnë akoma me njëra-tjetrën për të sqaruar gabimet që bëhen me gjëra shumë të thjeshta. Arsyeja që i kërkuam Këshillit ngritjen e komisionit hetimor nuk është të gjejmë gabimet e juaj, është të gjejmë zgjidhjet. Gabimet nga ana procedurale mund t'i shohi prokuroria apo kushdo ata që kanë dashur me shkelje e me përfituar nga ky projekt, sepse ka dhe të tillë. Po ne nuk po merremi. Nuk nuk është rasti juaj i këshilltarëve.

Këshilltarët kanë ngritur me vullnetin e tyre të lirë. Kanë menduar që është një projekt i mirë, apo është pa gabime fare? Sepse edhe në takimin në komisionin e kulturës që ka qenë rreth katër orë e gjysëm, deputetët e Durrësit aty për herë të parë e kuptuan gravitetin e situatës, ku ne i themi që

nuk ka projekte mbi objekte të cilat prishen, që kanë vlera arkitektonike, vlera historike e tjerë, e tjerë. Rishikojeni, të tjerët që e pranojnë le ta pranojnë. Kjo është historia.

Raprezaljet po na axhitojnë shumë. Kjo është situatë raprezaljesh.

Një minutë ta them Xhelil, historia e këtij bonusi është pa diskutim për ata njerëz që kanë nevojë dhe duhet, por ata normalisht nuk mund t'i merrni me zor, t'i çoni pa kontrata. Kemi eksperiencën e 5 Majit. Të gjithë njerëzit që janë çuar me bonus dhe nuk bëhet fjalë për bonus qeraje, bëhet për shtëpi sociale. Për shtëpi sociale po, bonusi i qerasë është dhënë vetëm në rastet tërmetit more zotëri, nuk ka lidhje me rastin tonë. Bonusi qeras nuk ka lidhje me rastin tonë. Megjithatë ata njerëz, është dora e parë atje si makt. Janë tre pleq atje që i ka ardhur vendimi, ata mbyllin derën se s'dinë ç'të bëjnë tjetër. Nuk ja marrin letërën KMT-së. Ata nuk e dinë që mbas 10 ditëve, fëmijët i kanë në Kanada, po merremi ne që t'i strehojmë. Bashkia minimalisht duhet t'i gjejë shtëpi, jo bonus qiraje duhet t'i kishte, ta kishte zgjidhur këtë situatë. Po kjo është dora e parë, që e kanë pranuar fatin e tyre që janë rrotull amfiteatrit. Kjo është diskutimi që kemi me ADF-në, me ministrinë, me bashkinë e cila nuk vjen asnjëherë në takimet tona. A thua se nuk ka lidhje me këtë bashki? Po megjithatë po ju them bonusi që rast ose specifikoheni për kë do jeni duke dhënë ose ndryshe njerëzit janë pikërisht në këtë gravitet se ju ka ardhur letra. Ai thotë me datë 15 do marr vendimin të të prish. Gjendja është dramatike, ndërkohë që ne i kemi akoma në posedim. Mos themi për raste që janë prishje pa e ditur mirë, vëjnë tjetër në letër e tjetër në dokumenta. Është, është domethënë situata është e paazhurne..

Hekuran Markola: Ne e japim dhe ata nuk e pranojnë.

Joniada Musaraj: Është hapje rruge....

Entela Koja: Jo nuk është hapje rruge e dashur. Jo nuk është hapje rruge. Jo, nuk është hapje rruge. Unë, unë them për momentin mos e aprovoni derisa të detajohen kush do e marrin atë bonus qiraje, sepse në bonus qiraje me justifikimin e bonusit të qerasë ata do t'i nxjerrin ata njerëz. Merrni këto lekë edhe ikni. Kjo është arsyeja. Dhe ashtu i kanë ardhur, i kanë ardhur në derë.

.... *Xhelilaj flet pa mikrofon....*

Entela Koja: Po mirë atë s'e di ti. Ato i kanë ardhur në derë. I kanë thënë, i kanë ardhur në derë, Xhelil, i kanë ardhur në derë dhe i kanë thënë, na jepni librezën e ujit, na jepni korrentit, na jepni kartën e identitetit. Çfarë do të thotë kjo sipas teje? Se do t'ju japim...

Po jo more, po prit se s'ka ardhur momenti i prishjes. Kjo është pse po nxitoni t'i prishni kur ata akoma i kanë, s'janë mbaruar procedurat Xhelil, nuk ka lidhje fare kjo me këtë. Ashtu i kanë thënë, i kanë thënë do t'ju japim bonus qiraje dhe do ikni. Historia është,.... ndërkohë që ne po negociojmë me institucionet.

Rolant Xhelilaj: Okej, okej, dakord.

Gjithë problemi ne për të qenë korrekt me veten edhe me ju, edhe me ata atje jashtë, pavarësisht përdorimit që i bëhet.

Entela Koja: Po mirë pra, përdorimi....

Rolant Xhelilaj: Përdorimi, nuk e kam me ty çke, ti s'je pjesë. Ti je pjesë me ata.

Entela Koja: Okej, okej.

Rolant Xhelilaj: Për mua dhe ti je e përdorur për këtë punë.

Të dhamë mundësinë që t'ia prezantosh grupit tonë, sepse pjesa tjetër u largua nga mbledhja, për të qenë korrekt me faktin që keni bërë një kërkesë. Ka ardhur vonë në fakt, sepse ka ca rregulla dhe pranimi i kërkesave dhe pjesëmarrja. Pjesëmarrja është e lirë. Kur është pjesëmarrje me objekt duhet bërë kërkesë me shkrim. Megjithatë pak rëndësi ka. Ju dhamë mundësinë, dhe ju dëgjuam, respekt për ty personalisht për formimin tënd, duke pranuar të drejtën tënde për të thënë gjëra pa pranuar ato që the raprezalje..

Entela Koja: Raprezalje është, më vjen keq.

Rolant Xhelilaj: Për ty, për ty, për ty. Proceset që ndodhin, zhvillimet që ndodhin kanë vështirësi për një kategori njerëzish dhe këtu hyjnë ata që një pjesë e mirë janë dhe miqtë tanë, por nuk pengohet një projekt i rëndësishëm për qytetin për arsye se disa nuk e gjejnë veten në kushte shumë të mira për ta përballuar këtë punë.

Entela Koja: Po nuk është ashtu Xhelil. Nuk është ashtu Xhelil.

Është bërë gabim. Janë projekte të bëra gabim.

Rolant Xhelilaj: O ti motër, shiko dhe njëherë fole. Mos fol më mirë. Mos fol më. Sepse në qoftë se është bërë gabim ti e di, ti e di ti je specialiste, je inxhinere, më fal, arkitekte urbaniste me reputacion në Durrës, i drejtoresh gjykatës për gabime. Këshilli Bashkiak nuk analizon gabimin e zyrës përkatëse. Zyra përkatëse mban përgjegjësi në qoftë se ka bërë gabime, në qoftë se ka mbivendosje që përdoret shprehja, në qoftë se ka interesa, ne jemi të parët këtu që nuk e pranojmë dot këtë lloj situatë.

Entela Koja: Për këtë e kërkuam komisionin hetimor.

Rolant Xhelilaj: Ajo është pjesë tjetër pastaj që s'ju takon të kërkon komision për arsye, sepse Këshilli Bashkiak ka një rregullore funksionimi të komisionit.

Entela Koja: Mua kështu mu tha dhe e bëra.

Rolant Xhelilaj: Pra okej, okej. Ne nuk hyjmë te ajo pjesë që ju doni të bëni. Bëjeni dhe për atë do merrni përgjigje. Edhe për pikën e sotme do merrnit përgjigjen tonë. Fakti që ato ikën, fakti që ne ty të dhamë mundësinë, nuk do të thotë që ne nuk kemi qëndrim për këtë pikë, ama për të

qenë korrekt, për t'jua thënë në sy dhe atyre që juve ju manipulojnë dhe ju thonë që atje po bëhet hataja.

Entela Koja: Se kanë fajin....

Rolant Xhelilaj: Tashi unë do jap opinionin tim të lutem, që po bëhet hataja, atje ka represion, atje njërit i hiqet, tjetrit i vihet, atje shihet ngjyra politike, sepse i dëgjuam në fillim kur hym aty...

Entela Koja: Jo jo nuk janë politike, janë interesa të vogla njerëzish. Nuk janë politike... I kemi të të gjitha koloreve.

Rolant Xhelilaj: Kur hym aty i dëgjuam nga ata njerëz.....Patjetër i dimë mirë, sepse kemi kontakte gjithë kohës. Unë bie dakort t'i kërkoj dhe nënkryetarit që këtë pikë ne ta kalojmë për mbledhjen e radhës dhe me shpjegimet që duhet të na vijin edhe nga zyra juridike e bashkisë.

Entela Koja: Me emra, me mbiemra...

Rolant Xhelilaj: Jo, jo.

Entela Koja: Po si jo?....

Rolant Xhelilaj: Bonusi është hera e parë është që e dëgjoj dhe kjo shoqja jonë dhe mikja jonë na futi në një linjë që kështu ka ndodhur te 5 maj i morën librezat. Merr ti mua librezën, ti në qoftë se unë s'dua librezën e ujit, librez e dritave?! Mi merr?....

Entela Koja: Ja dhe mua s'ma kanë marrë.

Rolant Xhelilaj: Po tani të lutem... ti të paktën këtu..

Entela Koja: Xhelil të diskutoj edhe njëherë. Kur njerëzit çohen për bonuse qeraje je dakort që bëhen me marrëveshje nuk çohen me zor.

Rolant Xhelilaj: Patjetër...

Entela Koja: Atëhere këtu bashkohemi bashkë.

Rolant Xhelilaj: Atëherë, pala tjetër nuk pret...

Entela Koja: Ata ja kanë dhënë të dhënat jo për marrëveshje.

Rolant Xhelilaj: O Entel, të lutem mos na bëj edhe ne budallenj tashi.

Entela Koja: Okej, okej ashtu e lëmë.

Rolant Xhelilaj: Pala tjetër ka gjithë të drejtën e vetë të mos pranojë.

Entela Koja: Ekzakt...

Rolant Xhelilaj: Edhe kaq. Dhe nuk ndikon as te zhvillimi, as te raprezalja, as te ndërhyrja brutale s'kanë lidhje fare. Janë formate ose forma të shprehuri për të ngritur opinionin negativ të atyre njerëzve sikur mbi ta po ushtrohet dhunë.

Entela Koja: Sepse përfaqësuesi i njësisë vendore i ka thënë i duam të dhënat për bonus qiraje.

Rolant Xhelilaj: Shiko mban përgjegjësi në qoftë se i ka thënë për atë. Jo, nuk ndodh.

Entela Koja: Po, po, të të çojë aty te njerëzit se kush ja ka thënë. Kazazëve ja kanë thënë, Laçit ja ka thënë, të gjithëve ia kanë thënë...

Rolant Xhelilaj: Të lutem, të lutem, të lutem se mos bëjmë debat...

Entela Koja: Po debat është mo Xhelil...

Rolant Xhelilaj: Jo nuk është debat se ne të dhamë të drejtën, fole, ne të dy kemi periudhë të gjatë që punojmë me administratën, edhe e dimë mirë se është edhe bonusi qirasë që ka procedurën e vetë, që duhet të bësh kërkesë të paraqitësh dokumentat e të gjitha me radhë, sepse ndryshe ...

Entela Koja: Po pra, por me zor nuk çohen njerëzit.

Rolant Xhelilaj: Po pra po, e kur ne e pranojmë këtë, ju s'e pranoni se thoni...

Entela Koja: Kush nuk e pranon? Unë po them me zor ti nuk më çon dot.

Rolant Xhelilaj: Ti e para, se ju thoni jo po është për raprezalje për t'i marrë.....

Entela Koja: Unë po them me zor ti nuk më çon dot.

Rolant Xhelilaj: Atëherë për çfarë ngrihet ky problem dhe bëhet gjithë ajo zhurmë atje?

Entela Koja: Sepse juve...

Rolant Xhelilaj: Sepse një miku im aty Isuf Idrizi më thotë: "...po votuat bonusit është tradhëti me ne..". Se ku është tradhëtia unë nuk e gjej dot këtu.

Entela Koja: Se i kanë ardhur dhe i kanë thënë...

Rolant Xhelilaj: Ore të thonë ç'të dojnë pozicioni jot është pozicioni jot, siç i ka thënë një aty...

Entela Koja: Është përfaqësues i shtetit ai që i ka ardhur, është përfaqësues, Tartarëve i ka ardhur, Laçëve i ka ardhur..

Rolant Xhelilaj: Shiko, nuk të beson njeri për këtë punë. Mos i hy këtij muhabeti.

Entela Koja: Nuk më besoni mua, pyesni të zotët e shtëpive.

Rolant Xhelilaj: Jo, jo.

Entela Koja: Jo Xhelil, nuk është ashtu si thoni ju...

Rolant Xhelilaj: Ne, të lutem Entel, të lutem mos ndërhy më...

Entela Koja: Okej. Okej.

Rolant Xhelilaj: Për një arsye të vetme, sepse ti the çfarë deshe, dëgjo çfarë të themi.

Ne kemi qëndrim sepse ne këtu nuk jemi thjeshtë përfaqësues të një partie. Jemi përfaqësues të qytetarëve të Durrësit. Dhe çdo situatë që ndodh me qytetarët e Durrësit, mos kujto se ne e kalojmë kaq lehtë dhe themi që: ...po mirë ohu, derisa e duam ne kjo të bëhet.

Jo, kërkojmë dhe ne shpjegime nga strukturat tona pse ndodh dhe pse bëhet dhe është miratimi total i Këshillit Bashkiak me ata zotërinjtë që bënë luftën në fillim që kanë thënë: "...është projekti më i mirë i mundshëm dhe është vonë duhet të ishte bërë me kohë...". Tani, del një sebeb që për mua nuk qëndron, një bonus dhe përdoret si argument nuk qëndron, për mua nuk qëndron dhe përdoret si argument se këtu po bëhet raprezalje. Këtë duhet ta tërhiqni jo vetëm ju, por dhe ata atje poshtë me ofendimin që u bëjnë anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Entela Koja: Shko dëgjoji atje dhe ta thonë historinë e bonusit.

Rolant Xhelilaj: Megjithatë, nuk e di.... zonja nënkryetare jeni dakort për mungesë të palës tjetër për të mos dhënë mesazhin që ne s'kemi nevojë për ata dhe realisht nuk kemi nevojë për ata. Jua thashë edhe këtu, unë me përvojën që kam anëtar këshilli mund të tregoj me qindra raste të prekura, por nuk ka rëndësi. Ne jemi ndryshe. Ne jemi dakort të shtyhet për mbledhjen tjetër. Argumentat e zonjës i dëgjuam. Argumentat tona po i lëmë t'i themi radhës tjetër. Të dëgjojmë edhe komentet e bashkisë së Durrësit dhe të marrim vendim për këtë pikë.

Joniada Musaraj: Kryetar vetëm një diçka kisha. Unë do ta nis nga fundi i fjalës tuaj.

Zonja Koja apo jo mbiemri mos gaboj. Atëhere zoti Xhelilaj ka një të vërtetë në fakt që ne kur votojmë si anëtarë këshilli këtu, ne jemi përfaqësues të të gjithë qytetarëve, që do të thotë jemi dhe të atyre qytetarëve që janë dakort me këtë projekt.

Entela Koja: Pa diskutim.

Joniada Musaraj: Po e nis nga kjo.

Së dyti, dua të ndalem te procedura dhe ta jap si këshillë, nuk je juriste dhe e kuptoj dhe ndoshta dhe disa gabime dhe nga ana procedurale. Unë i kam parë dhe ju kam ndjekur. Dua t'ju sqaroj pozitën tonë dhe të opozitës që u largua. Në dijeninë time ju keni shprehur dëshirën për të ngritur një komision hetimor. Ne si grupim jemi të hapur sa herë të paraqiten kërkesa për komisione hetimore, që unë ju premtoj jemi të hapur për të parë nëse është e bazuar apo jo kjo kërkesë dhe po ju sqaroj që ju kanë sorrollatur pikërisht ata që u larguan gjithë këto ditë.

Entela Koja: Po e di, e di.

Joniada Musaraj: Dhe unë e kam informacionin patjetër e kam informacionin, madje atyre u është bërë dhe kërkesa me telefon që të firmosin për komisionin hetimor dhe po jua them dhe përgjigjen e tyre që ka qenë jo. Dhe unë ndjej keqardhje, sepse minimalisht nga ana politike ata siç kanë shfrytëzuar çdo rast mund ta kishin shfrytëzuar dhe këtë. Për procedurë ju sqaroj që komisioni hetimor me rregullore kërkohet nga anëtarët e këshillit dhe ju me të drejtë keni kërkuar mbështetje tek ata dhe përgjigjen që keni marrë ka qenë “jo”. Është e saktë.

Entela Koja: Nuk ka qenë jo. Do bëjmë 50 firma që ta paraqesim...Nuk kanë thënë jo .

Joniada Musaraj: Unë e kam informacionin, e kam informacionin e saktë dhe e kam burimin shumë të sigurtë,.....

Entela Koja: Jo, nuk kanë thënë jo.

Joniada Musaraj:sepse në të kundërt në gjithë këto ditë që është dashur për t'u bërë mbledhja do u kishin ofruar mbështetje dhe do ishin të parët.

Entela Koja: Ne na kanë thënë që nuk ka asgjë të keqe të ngrihet ky komision.

Joniada Musaraj: Po them, informacionin që unë kam...

Entela Koja: Në qoftë se s'keni gjë për të fshehur, pse jo.

Joniada Musaraj: Jo absolutisht. Unë ju tregoj dhe si është për procedurë. Ju tregoj dhe çfarë mund të kishin bërë ata, ndryshe çfarë bëjmë ne. Unë jam kritikuar madje pse e diferencoj ne dhe ju. Kështu që kjo është arsyeja.

Dhe së treti unë ju bëj një pyetje. Cila është ndihma që ju vjen ju dhe jam shumë e sinqertë në këtë që ju them në mosmiratimin. Jam dakord me kryetarin e grupit për shtyrje së pari. Cila është ndihma, më mirëkupto, cila është ndihma, bllokimi që i vjen procesit të prishjes nga votimi sot? Flas, po flasim për pikën 13.

Entela Koja: Ka disa raste të konstatuara nga ne dhe këto po nxitojnë të bëjnë procedurat e prishjes.

Joniada Musaraj: Është tjetër gjë. Këtë po ju them...

Entela Koja: Sepse bonusi i qirasë i është dhënë pikërisht këtyre njerëzve.

Joniada Musaraj: Dua të jem shumë dashamirëse ndaj jush. Edhe sikur pro të ishte votuar sot, jam e bindur që pasoja që do vinte nuk do të kishte lidhje fare me procesin, që ju po e paraqisni tek ne, pra këtë dua që ti të jesh e qartë dhe ta ndash.

Entela Koja: Duam ta pezullojmë

Joniada Musaraj: Madje dhe qytetarët që protestojnë unë dua që të jenë të qartë.

Denisa Luarasi: Zonja Musaraj unë mendoj që të na sqarojë...

Joniada Musaraj: Faleminderit e zgjata e vërtetë është.

Denisa Luarasi: Jo s'ka problem.

Unë mendoj ta sqaroj pikën 13 nënkryetari i bashkisë ose një nga administrata. Të na sqaroj dhe pastaj do mbajmë qëndrimin e kryetarit të grupit.

Gentian Kallmi: Përshëndetje të gjithëve.

Atëherë, referuar pikës 13 ju sqaroj se me shumë mundësi ka pasur një keqinterpretim për pikën 13. Pika 13 propozon një angazhim fondesh buxhetore nga fondet e emergjencës të bashkisë për projektin TID për familjet e interesuara. Do të thotë që vullneti, vullnetin e ka familja e prekur që të aplikojë për programin e këtij strehimi, dhe nuk miraton emra, angazhon një fond buxhetor dhe mënyrën e kërkimit të këtij fondi buxhetor në rast se është e interesuar për subvencionim qiraje.

.....Flasin disa këshilltarë dhe qytetarja Koja njëkohësisht.....

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti nënkryetar.

Atëherë shumë faleminderit nënkryetar.

Atëherë do mbajmë qëndrimin tonë si grup, të grupit që do ta shtyjmë për...

Joniada Musaraj: Duhet ta hedhim në votim.

Denisa Luarasi: Po foli kryetari i grupit i grupit.
Atëhere, po.

.....*Flasin disa këshilltarë njëkohësisht*

Denisa Luarasi: Po zoti Xhelilaj, zoti Xhelilaj, sikur....
Kërkoje pak të flasësh.

Rolant Xhelilaj: Po po. Mirë dakord, je dakord. Shiko ne do ta miratojmë kemi rastin në mbledhjen tjetër që do ta miratojmë natyrisht.

.....*Flasin disa këshilltarë dhe qytetarja Koja njëkohësisht*.....

Rolant Xhelilaj: Jo, nuk ka problem Nuk ka lidhje, nuk ka lidhje me terrorin. Nuk, shiko sa kemi dëgjuar dhe sa kemi bërë. Jemi të gjithë pjesë e kësaj loje politike. Po nuk ka rëndësi. Ata kanë hall dhe ne jemi me hallin dhe të dëgjojmë shpjegimin. Shpjegimi i bashkisë është ky dhe ne kemi bindje që kjo është. Por, ngaqë ato mungojnë aty dhe mos thonë që ja ju shfrytëzuar rastin që ne s'jemi, ne votën do ta japim mbledhjen tjetër në prani të të gjithë anëtarëve të këshillit. Me shpjegimin që do na vijë, edhe për këtë koment që bën zonja që një nga bashkia ju kanë thënë që juve po ju merren emrat e këto, për t'ju dhënë bonusin edhe ndërkohë i shkojnë dhe letrat. S'ka lidhje, s'është e vërtetë. Projekti është projekt. Në rast se projekti ka probleme, ka drejtim të caktuar për t'u ankuar, për ta ndjekur, për ta ndaluar. Në qoftë se, që mua s'më duket shumë normale, të vjen keq për këdo që preket. Por zhvillimi ka dhe problemet e veta. Bashkisë i kërkohet transparencë, koherencë në zbatimin e problemeve që shtrohen nga qytetarët para saj. Për arsye të situatës së krijuar te mbledhja, unë propozoj të shtyhet.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

.....*Flasin disa këshilltarë në sallë njëkohësisht*.....

Denisa Luarasi: Atëherë pikën 13 e shtyjmë për mbledhjen tjetër.

Flutura Kasa: Unë mbështes fjalën e Landit, por, por kisha vetëm diçka. I them përfaqësueses së qytetarëve pavarësisht komenteve që po bëhen nëpër portale nuk më intereson shumë. Madje përkundrazi më bëjnë një çik kështu figurë. Më kupton? Por mos i jepni ngjyra politike se është më mirë për ju, se kjo sot do komentohet atje poshtë si fitore e PD-së dhe jo si një llogjikë e pastër dhe mbështetje e Partisë Socialiste bashkë me mua si Socialdemokrate.

Entela Koja: Ju bën nder të gjithëve ju, ju thjesht jepini pak kohë.

Llesh Çuni: Kjo që bëjmë ne s'ka lidhje me projektin fare.

.....*Këshilltarët ngrihen për të ikur....*

Denisa Luarasi: Ju lutem, ju lutem....

Dorina Milja: Prisni, s'është mbyllur mbledhja. Ta mbylli mbledhjen.

Denisa Luarasi: Prisni pak.

Flutura Kasa: Do ta hedhim në votim?...

Denisa Luarasi: Jo, jo s'ka s'ka nevojë për..., s'ka nevojë për votim.

Atëherë pika e 13 do kaloj për mbledhjen tjetër.

- Ka kërkuar fjalën Anisa Ibraj për diskutim, e cila nuk ndodhet e pranishme. Administrata e bashkisë i ka kthyer përgjigjen me shkrim.

Kështu që ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit për angazhimin tuaj. Mirupafshim.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 43 (dyzet e tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Nikol Muka

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i seancës (Kryetar i Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretar i Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit) :	JONIADA MUSARAJ
Këshilltar (Kr.Grupi) :	LUAN NEZHA
Këshilltar (Kr. Grupi):	FLUTURA KASA